

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap - Kz 387/11

13 mars 2012

N Ë E M È R T Ë P O P U L L I T

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Horst Proetel, si Kryetar i kolegjit dhe nga anëtarët e kolegjit Avdi Dinaj, gjyqtar i Gjykatës Supreme dhe nga gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore Chiara Rojek, si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër:

Marko Jablanovic, me nofkën I .., i biri i

.., më herët i dënuar për veprën penale Mbjtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve me Aktgjykimin e formës së prerë P. Nr. 28 / 09 të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës duke e dënuar me gjashtë (6) muaj burgim, i cili ka qenë në paraburgim nga data 9 gusht 2007 deri më 30 gusht 2007, ndërsa në arrest shtëpiak nga data 31 gusht 2007 deri më 28 shtator 2007,

I akuzuar në bazë të Aktakuzës PP. Nr. 232 / 2007 e cila është ndryshuar në mënyrë verbale nga Prokurori i EULEX-it gjatë seancave gjyqësore në veprën penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229, paragrafin 3, lidhur me Nenin 20 dhe 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) si dhe Mbjtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së, i dënuar në shkallën e parë me Aktgjykimin P. Nr. 244/2007 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 5 maj 2011 për veprën penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm, në kundërshtim me Nenin 229, par. 1 të KPPK-së, dhe Mbjtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së i dënuar me një (1) vit burgim dhe duke i shqiptuar gjobë prej pesëdhjetë (50) euro dhe një (1) vit burgim, me një dënim unik prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim dhe gjobë prej pesëdhjetë (50) euro, në bazë të Nenit 71, par. 1 dhe par. 2, pika 2 të KPPK-së,

Duke vepruar sipas ankesës së ushtruar nga Avokati mbrojtës Ljubomir Pantovic në emër të të pandehurit Marko Jablanovic më 20 korrik 2011 dhe Ankesës së ushtruar nga i pandehuri Marko Jablanovic më 12 shtator 2011 kundër aktgjykimin P nr. 244/2007 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 5 maj 2011, dhe duke marrë parasysh Mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) të paraqitur më 31 tetor 2011,

Pas mbajtjes së seancës publike më 13 mars 2012 në praninë e të pandehurit Marko Jablanovic dhe Avokatit të tij mbrojtës Ljubomir Pantovic, pas këshillimit dhe votimit po atë ditë,

Në përputhje me Nenin 420 e tutje të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës lëshon këtë:



AKTGJYKIM

1. Ankesa e ushtruar nga Avokati mbrojtës Ljubomir Pantovic në emër të të pandehurit Marko Jablanovic dhe Ankesa e ushtruar nga i pandehuri Marko Jablanovic më 20 korrik 2011, përkatësisht më 12 shtator 2011, kundër aktgjykimit P nr. 244/2007 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 5 maj 2011, **PRANOHEN** pjesërisht.
2. Të gjitha pjesët e mbetura të Ankesave **REFUZOHEN** si të pabazuara.
3. Aktgjykimi P nr. 244/2007 i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i datës 5 maj 2011 **NDRYSHOHET** siç vijon:

“I pandehuri **Marko Jablanovic** është dënuar me burgim prej katër (4) muaj dhe me gjobë prej pesëdhjetë (50) Euro për veprën penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 229, Paragrafit 1 të KPK-së. Koha e kaluar në paraburgim prej 9 gusht 2007 deri më 30 gusht 2007 dhe koha e kaluar në arrestin shtëpiak prej 31 gushtit 2007 deri 28 shtator 2007 do të llogaritet në pajtim me Nenin 73, Paragrafin 1 të KPK-së.

Dënimi me burgim nuk do të zbatohet nëse i akuzuari nuk e kryen ndonjë vepër tjetër penale në periudhën kohore prej një (1) viti në pajtim me Nenin 44, Paragrafët 1, 2 dhe 4 të KPK-së.

I pandehuri **Marko Jablanovic** është dënuar me gjobë prej katërqind (400) Eurove për veprën penale të Mbjajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi 2 të KPK-së.”


4. Shpenzimet e procedurës penale në shkallën e dytë do të barten në buxhetin e Kosovës në pajtim me Nenet 99, 100 dhe 103 të KPPK-së.

ARSYETIMI

I. Historia e procedurës

Më 26 shtator 2007 është ushtruar aktakuza PP. nr. 232/2007 nga Prokurori i Qarkut duke e akuzuar Marko Jablanovic me veprat penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229, paragrafin 4, nën paragrafi 1 lidhur me paragrafin 23 të KPPK (Pika 1) si dhe Mbjajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së, (Pika 2). Të dy të pandehurit e tjerë po ashtu janë të akuzuar. Aktvendimi Kp nr. 244/07 i datës 12 nëntor 2007 është konfirmuar në tërësi. Lënda është marrë nga gjyqtarët e EULEX-it më 2 dhjetor 2010.

Aktakuza PP. Nr. 232 / 2007 është ndryshuar në mënyrë verbale nga Prokurori i EULEX-it gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore në lidhje me Pikën 1. Marko Jablanovic ishte akuzuar me veprat penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229, paragrafin 3, lidhur me Nenet 20 dhe 23 të KPPK.



Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në maj 2011. Në hapje të shqyrtimit i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për Pikën 1 ndërsa fajtor për Pikën 2. Më 5 maj 2011, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës ka nxjerrë Aktgjykimin P. Nr. 244/2007 me të cilin Marko Jablanovic u shpall fajtor për Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229, par. 1 të KPPK-së "sepse më 9 gusht 2007 rreth orës 15:00 pranë urës hekurudhore, në Kampin e romëve në Mitrovicë, pa pasur autorizim për të blerë substanca narkotike, ai kishte blerë 6 qese plastike me marihuanë (kanabis) me peshë të përafërt prej 25.5 gramësh nga personi Kujtim Sahiti. Ai kishte për qëllim ta përdorte vetë drogën në fjalë dhe ta shpërndante tek miqtë e vet." (Pika 1). Më pastaj i njëjti u dënua për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 të KPPK-së "sepse gjatë periudhës së panjohur kohore deri më 9 gusht 2007, pa pasur autorizim kishte mbajtur në pronësi 364 plumba të kalibrit 7.62 mm dhe gaz lotsjellës të llojit M – 3 F të quajtur 'CS', që iu gjetën në makinën e tij pa numër të regjistrimit më 9 gusht 2007." (Pika 2). Ai ishte dënuar me një (1) vit burgim për Pikën 2. Atij iu shqiptua dënimi unik prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim si dhe gjoba prej 50 eurosh.¹ I pandehuri i dytë po ashtu është dënuar ndërsa i treti është liruar.

II. Parashtrësat e palëve

A. Ankesa e të pandehurit Marko Jablanovic

I pandehuri ka parashtuar Ankesë për shkelje esenciale të dispozitave të ligjit të procedurës, për vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike, për shkeljen e ligjit penal dhe për vendimin mbi dënimin. Ai propozon që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke e liruar ose të anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.


Ai pohon se janë shkelur dispozitat e KPPK-së pasi që trupi gjyqësor i shkallës së parë nuk ka qenë i formuar ashtu si duhet.

Ai thekson se droga të cilën e kishte siguruar ishte vetëm për shfrytëzim personal. Fakti që kishte theksuar qëllimin për ta shpërndarë marihuanën tek miqtë e vet ishte një shkujdesje e rastit, pasi që sasia në fjalë ishte e vogël. Gjykata e shkallës së parë nuk është dashur ta trajtojë ndryshe Marko Jablanoviqin i cili u shpall fajtor e ndryshe të pandehurin e tretë i cili u lirua për të njëjtën akuzë. Ai pohon se Gjykata e shkallës së parë është dashur të merrte parasysh që municioni i konfiskuar nga policia ka qenë i papërdorshëm.

Ai përsëri kundërshton dallimin e trajtimit në mes të të pandehurit të dytë i cili kishte shpërndarë sasi dy herë më të madhe të drogave ndërsa i ishte shqiptuar dënimi me kusht, ndërsa atij dënimi me burgim për një vepër më të lehtë në bazë të Nenit 328, par. 2 të KPPK-së. Në fund, Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka marrë parasysh dënimin e mëhershëm si rrethanë rënduese, edhe pse vepra penale për të cilën ishte dënuar ishte kryer në vitin 2009, pra shumë kohë pas kryerjes së veprave penale me drogë dhe me armë në gusht të vitit 2007.

B. Ankesa e avokatit mbrojtës Ljubomir Pantovic

¹ Gjykata e Qarkut, përmes aktgjykimit të saj, po ashtu ka urdhëruar që koha e kaluar në pritje të lirë nga data 9 gusht 2007 deri më 30 gusht 2007 si dhe arresti shtëpiak nga 31 gushti 2007 deri më 28 shtatori 2007 duhet të llogariten në kohëzgjatje të dënimin në bazë të Nenit 73, par. 1 të KPPK-së.



Avokati mbrojtës deklaroi se aktgjykimi i kundërshtuar përmban vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal. Ai po ashtu kundërshton vendimin mbi dënimin. Ai kërkon që Gjykata Supreme të kthejë aktgjykimin e kontestuar duke e liruar të pandehurin, ose ta anulojë dhe ta kthejë lëndën për rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë.

Sa i përket akuzës për drogë, Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë faktet në dispozicion. Në shumicën e vendeve evropiane, prania e THC-së (tetrahydrocannabinol) në marihuanë duhet të jetë më e lartë sesa 0,30%, për t'u konsideruar si drogë e kundërligjshme. Raporti i ekzaminimit nuk përmban asnjë informacion lidhur me këtë aspekt.

Lidhur me akuzën për armë, avokati mbrojtës përmend gjendjen e keqe të municionit të konfiskuar, për shkak të korrozionit dhe ngre dyshime nëse një municion i tillë mund të konsiderohet si armatim fare, në bazë të Nenit 107, pikës 28 të KPK-së. Gjykata duhet të veprojë në të mirë të të pandehurit, siç përcaktohet me Nenin 3, par. 2 të KPPK-së.

Rrjedhimisht, Gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal. Avokati mbrojtës pretendon se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është tejte i ashpër. Shumë rrethana lehtësuese janë në favor të të pandehurit, ndërsa vetëm një rrethanë është rënduese: i pandehuri ishte dënuar më herët për armëmbajtje por ishte liruar për akuzën e vrasjes në tentativë, pasi që kishte vepruar në vetëmbrojtje.

C. Opinioni i Prokurorit të Shtetit të Kosovës

Prokurori i Shtetit propozon që Gjykata Supreme e Kosovës të refuzojë të dy ankesat si të pabazuara ndërsa të vërtetojë Aktgjykimin e shkallës së parë.

ZPSHK-ja i referohet Nenit 4, par. 7 të Ligjit mbi kompetencat për të vërtetuar se trupi gjykues ishte formuar në mënyrë të rregullt.

Prokurori i Shtetit pretendon se marihuana e konfiskuar e cila përmban THC është substancë narkotike në kuptimin e definicionit të "narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike", sipas Nenit 107, pikës 29 të KPK-së. Ai është i mendimit se shprehja "armë" në bazë të Nenit 107, pikës 28 të KPK-së gjithashtu përfshin edhe të gjitha llojet e municionit, pavarësisht nëse të njëjtat janë akoma funksionale apo jo. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e saktë të gjendjes faktike dhe drejt ka zbatuar ligjin penal.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

A. Juridiksioni dhe procedura para Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës është gjykatë kompetente për të vendosur rreth Ankesave në bazë të Nenit 26, par. 1 dhe Nenit 398 të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me Nenin 3 Paragrafin 7 të Ligjit nr. 03/L-53 mbi Kompetencat. Seanca publike është mbajtur më 13 mars 2012 në të cilën palët ishin ftuar.

B. Pranueshmëria e ankesave të parashtruara nga i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës

Gjykata Supreme konstaton se të dy ankesat janë të pranueshme në pajtim me Nenin 398 dhe 399 të KPPK-së.



Aktgjykimi i kontestueshëm është i datës 5 maj 2011. Avokati mbrojtës Ljubomir Pantovic po të njëjtën ditë paralajmëroi qëllimin e tij për tu ankuar. Ai ka pranuar aktgjykimin më 6 korrik 2011 dhe ka dërguar ankesën më 20 korrik. Marko Jablanovic pranoi aktgjykimin më 1 shtator 2011. Ankesa e të pandehurit është regjistruar në gjykatë më 12 shtator 2011. I është transmetuar prokurorit të EULEX-it më 14 shtator 2011.

Ankesat janë të pranueshme edhe nëse i pandehuri është deklaruar fajtorë për akuzën e Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve. Dënimi në shkallën e parë e arsyeton ankesën. Për më tepër, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës kanë ushtruar ankesë kundër vendimit mbi sanksionet penale.

C. Meritat e lëndës

Gjykata Supreme e Kosovës refuzon si të pabazuar pjesën e ankesës lidhur me shkeljet substanciale të dispozitave të ligjit të procedurës. Për më tepër, ankesat nuk janë të bazuara sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dënuar të pandehurit për të dyja akuzat.

Parashtresës së mbrojtjes për përbërjen jo të rregullt të trupit gjykues i mungojnë arsyet. Kolegji i shkallës së parë është formuar në mënyrë të rregullt sipas Nenit 4, Paragrafit 7 të Ligjit mbi Kompetencat.


Gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar saktë të gjitha faktet e nevojshme. Prandaj, ankesat nuk janë të arsyetuar bazuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas Nenit 403, Paragrafit 3 të KPPK-së.

Sa i përket veprës penale të Blerjes, Posedimit, Shpërndarjes dhe Shitjes së Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe të Substancave Psikotropike në kundërshtim të Nenit 229, Paragrafit 1 të KPK-së, Gjykata e Qarkut ka konstatuar që i pandehuri ka blerë lëndë narkotike me qëllim që një pjesë t'ja dërgoj shokëve të tij që ai dëshironte ti takonte në Mal të Zi.

Siç është theksuar saktësisht, substanca e siguruar për qëllim ka pasur që pjesërisht ti shpërndahet të tjerëve siç parashihet në Nenin 229 të KPK-së. Neni 107, pika 29 e KPK-së definon termin "drogë të rrezikshme dhe substanca psikotropike" sikurse substancat e radhitura në gazetën zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nr. 70/78, 14/81, 39/82, 28/85, 10/87, 53/88, 2/89. Kjo rezulton nga raporti kriminalistikës të Njësitit të drogës të datës 10 shtator 2007 shprehimisht duke theksuar që substanca përmban substancë të palejueshme droge tetrahydrocannabinol (THC). Ky artikull është i radhitur nën kanabis nr. 69 (Kërpi (drogë e nxjerrë nga kërpi) Indian) të listës së cituar të RSFJ-së së narkotikëve.

Mbrojtja në mënyrë të gabueshme pohon që Gjykata e Qarkut nuk ka arritur të përcaktoj që substanca e konfiskuar ka përmbajtur më tepër se 0,30 % të THC-së, e cila vetëm do të ketë efekt të trulllosjes së marihuanës. Është e vërtetë që sasia e THC ka rëndësi domethënëse për produktin. Megjithatë, ligji i aplikueshëm nuk e përshkruan përqindjen specifike të THC-së si kërkesë për dënim sipas Nenit 229 lidhur me Nenin 107, pikës 29 të KPK-së, por vetëm dëshminë që substanca përdorur përmban substancën e radhitur në listë.

Sa i përket asaj që i pandehuri pretendon për diferencimin e padrejtë në mes të bashkësive të pandehurit të liruar dhe atij, ai nuk e konsideron që ai – në kundërshtim me tjetrin



ka pranuar qëllimin e tij për të ndarë lëndën me shokët në Mal të Zi. Edhe kur bashkë i pandehuri do të ishte liruar në mënyrë të gabueshme, kjo nuk ka pasur efekt pozitiv për Marko Jablanovic pasi që askush nuk mund të pretendoj për barazi në padrejtësi. Përfundimisht, duhet të vërehet që i pandehuri, përdorues i rregullt i marihuanës, e ka provuar marihuanën dhe ka aprovuar duke e nënvizuar pasi që ai e ka ditur kualitetin e kënaqshëm të drogës.

Sa i përket veprës penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafit 2 të KPK-së, Gjykata e Qarkut me të drejtë ka dënuar të pandehurin. Nuk ka pasur nevojë për vërtetim të mëtutjeshëm të gjendjes faktike, kryesisht për qartësim nëse municionet e gjetura janë ende funksionale për shkak të fazës së prishjes.

Neni 107, pika 28 definon që arma në kuptim të Nenit 328 të KPK-së. Nën këtë dispozitë, shprehja "armë" do të thotë një mjet i prodhuar që përdoret ose është i përshtatshëm të përdoret për të shkaktuar lëndime trupore. Në mes tjerash, përfshin të gjitha llojet e municionit, [...]". I pandehuri ka pasur 364 plumba të kalibrit 7,62 dhe kanistër lotsjellës të llojit M-3F që përmbante lëndë kimike të quajtura 'CS' në posedim të tij. Ky municion është caktuar të shkaktoj lëndime trupore. Prandaj, është e domosdoshme për të konstatuar nëse ka qenë e përdorshme më tutje për shkak të fazës së prishjes. I pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për shkeljen e ligjit, kur është deklaruar fajtor për këtë akuzë.

Sa i përket vendimit për sanksionet penale, ankesat janë pjesërisht të bazuara. Sa i përket akuzës së drogës, dënim i zbutur me burgim dhe gjoba e caktuar prej pesëdhjetë (50) Eurove janë të mjaftueshëm për sanksionimin e veprës penale. Neni 229 Paragrafi 1 i KPK-së parasheh sanksione të gjobave dhe – në mënyrë kumulative – të burgimit prej një deri në pesë vite. Edhe pse aktgjykimi i atakuar ka shqiptuar gjobë minimale dhe dënim prej një (1)-viti burgim, situata konkrete kërkon zvogëlim deri në minimum të dënimit me burgim.

Nenet 65, 66 dhe 67 të KPK-së i mundësojnë gjykatës ti shmanget prej dënimit të përcaktuar nga ligji. Nën Nenin 67, Paragrafin 4, dënimi me burgim për një vepër të tillë penale mund të zvogëlohet deri në tre muaj. Këto parakushte janë përmbushur për shkak të rrethanave të veçanta lehtësuese duke arsyetuar që të shqiptohet dënim më i butë siç parashihet në Nenin 66, Paragrafi 2.

I pandehuri ka kryer veprën penale vite më parë, në vitin 2007. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është shpallur vetëm në maj të vitit 2011; aktgjykimi i Gjykatës Supreme bile është realizuar në mars të vitit 2012. Që nga viti 2007, procedura penale kundër të pandehurit për të cilin rezultati është i paqartë janë në vazhdim e sipër. Ai ka vuajtur heqje ose kufizim të lirisë nga masat e paraburgimit dhe të arrestit shtëpiak. Ndjekja penale e kësaj vepre në mënyrë të qartë ka ngulitur atë, duke e parandaluar atë për përsëritjen e mëtutjeshme të veprave penale. Së paku nuk ekzistojnë të dhëna të vërtetuara deri më tani.

Rrethanë vendimtare lehtësuese është fakti që shkelja e Nenit 229 përfshin një sasi shumë të vogël të drogës dhe dënimi është bërë i mundur vetëm atëherë prej rëfimit të pandehurit. Duke marr parasysh qëllimin e dënimit sipas Nenit 34, Paragrafit 1 të KPK-së, kjo mund të arrihet me burgimin prej katër (4) muaj duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak.



Dënimi prej katër (4) muaj veçmas nga gjoba e nevojshme minimale prej pesëdhjetë (50) Eurove, mundet – në mënyrë të veçantë – të pezullohet sipas Neneve 43 dhe 44 të KPK-së. Gjykata ka marr parasysh rrethanat e veçanta të Nenit 44, Paragrafit 3, kryesisht qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryerësit të veprës, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale. Siç u përshkruan, rrethanat e favorshme lejojnë të refuzohet ekzekutimi i dënimit të shqiptuar. Mund të merret përgjegjësia për këtë përjashtim, edhe pse sanksionet e rregulltat për këtë lloj të veprës penale kërkojnë dënimin me burgim më të gjatë dhe ekzekutim të dënimit të tillë.

Ndëshkimi për akuzën e Posedimit të Paautorizuar të Armëve kërkon vetëm gjobën prej 400 Eurove. Korniza e dënimit sipas Nenit 328, Paragrafit 2 është gjoba deri në 7.500 Euro ose dënimi prej një deri në tetë vite.

Gjykata Supreme konsideron që sanksioni për gjobë deri në një përmbajtje modeste është i mjaftueshëm. Duhet të shihet që municioni pa mjetin e të shtënit është armë e rrezikshme e kufizuar. Aspekti kryesorë për zbutjen e dënimit të shqiptuar është që Gjykata e Qarkut është ndjerë e lidhur të refuzoj gjobën si dënim të përshtatshëm për shkak të dënimit të mëparshëm të të pandehurit për Posedim të Paautorizuar të Armëve në vitin 2009. Ka dështuar të marr parasysh që vepra penale që është subjekt i procedurës së tanishme është kryer që në vitin 2007, që do të thotë që i pandehuri nuk ka pasur ndonjë dosje penale në atë kohë.

Pasi që dënim me burgim dhe me gjobë i është shqiptuar për akuzën e drogës dhe dënimi me gjobë për akuzën e armës, nuk ekziston baza për dënim unik në pajtim me Nenin 71 të KPK-së. I pandehuri është paralajmëruar që dënimi me kusht mund të tërhiqet nëse ai kryen vepër të re penale brenda periudhës kohore prej një (1) viti sipas Nenit 45 të KPK-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, vendimi bazohet në Nenin 99 të KPPK-së.

Kryetari i kolegjit:

Horst Proetel, Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i kolegjit:


Martti Harsia, Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i kolegjit:

Avdi Dinaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Procesmbajtëse:

Chiara Rojek, Zyrtare ligjore



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

13 mars 2012

Ap – Kz 387/11

Prishtinë